

KARTELE INFORMATIVE				
				AL112048
1. Emri i shërbimit	Sigurim vullnetar si vjetërsi për efekt pensioni			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Duke bërë sigurim vullnetar, personi blen periudha kontributive të vlefshme këto vetëm si vjetërsi për pensionin e pleqërisë, invaliditetit dhe atij familjar			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Të gjithë ata persona që për arsye të ndryshme nuk janë pjesë e sigurimit të detyrueshëm, mund të sigurohen vullnetarisht për periudha të kaluara ose aktuale, duke lidhur marrëveshje me ISSH. Marrëveshja për sigurimin vullnetar lidhet midis personit të interesuar dhe Inspektorit të sigurimit vullnetar në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Duke bërë sigurim vullnetar, personi blen periudha kontributive të vlefshme si vjetërsi për pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar			
4. A jam përfitues?	1.Të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç deri në arritjen e moshës për pension dhe që për shkaqe të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm; 2.Nuk lejohet sigurimi vullnetar pas lindjes së të drejtës për përfitim nga skema e sigurimit të detyruar; 3.Janë të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e tyre; 4.Nuk janë pjesëmarrës në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi; 5.Kur personi i interesuar ka lënë shtetësinë shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga 01.01.1994 deri në datën kur ka lënë shtetësinë; 6.Sigurim vullnetar mund të kryejnë dhe ata persona të cilët kanë plotësuar kushtin e moshës për pension, por nuk plotësojnë kushtin minimal për efekt pensioni; 7.Ky shërbim mund t'i jepet një personi të tretë të pajisur me prokurë nga i interesuari.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Librezë pune ose fotokopje e saj	Aplikanti	Po
	2	Fotokopje e nënshkruar e Kartës së Identitetit	Aplikanti	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Agjencia Lokale e Sigurimeve Shoqërore (ALSSH)	Në çdo qytet të Republikës së Shqipërisë, ku ju keni vendbanimin	Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore që gjenden në çdo qytet të Shqipërisë	ALSSH: E hënë- e premte, ora 08:30 - 16:00 E shtunë, ora 08:30 - 12:00 DRSSH: E hënë - e enjte, ora 08:00 - 16:00 E premte, ora 08-00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
	Ofrohet informacion mbi shërbimin	Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Shërbimi ofrohet tërësisht online
				
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	Shërbim pa pagesë	Nuk ka		
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	3 ditë (Shërbimin qytetari e merr menjëherë sa bën pagesën, dhe me këtë mandat pagesë certifikohet si kontribues i skemës)			
10. Çfarë përfitoj?	Kopje të marrëveshjes të firmosur nga të dy palët			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Pa afat (por jo më shumë se momenti i lindjes së të drejtës për përfitim nga ligji i sigurimeve shoqërore)			
12. Ku e marr?	Në sportele	Me postë	E-albania	Me e-mail
				
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në:		Orari	
	E- albania:e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al ISSH web: www.issh.gov.al; kontakt@issh.gov.al Call Center: 11800		Call Center: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele	Me postë	Web-i i Institucionit	Me e-mail
				
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al			
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Rregullore nr. 4, e ISSH-së, datë 25.05.2009 “Për sigurimin vullnetar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore” ne zbatim të këtij Ligji.			